



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 497/4 prot.
2023

Tiranë, më 22. 05.

V E N D I M

Nr. 76, datë 22. 05. 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,² shqyrtoi ankesën me nr. 206 Regj., datë 23.12.2022³, të S. H. kundër Kompanisë së Transportit Urban “Shpresa-Al-Transport” sh.p.k., me pretendimin për diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar⁴”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Në datë 28.12.2022, rreth orës 09:40, tek stacioni Institutit Bujqësor, kam hipur në autobusin e linjës urbane Tiranë-Kamëz. Pas nisjes së autobusit fatorino më kërkon lekët, i tregova librezën e verbërisë dhe ai më tha se nuk e njeh librezën e verbërisë, por vetëm librezat e lëshuara nga Shoqata e A. O. Pas një debati me fatorinon u detyrova të paguaj biletën: Seria 56/22, nr. 0689817, me vlerën 40 lekë. Gjithashtu, më datë 01.01.2023, rreth orës 11:40, kam marrë autobusin e Shoqërisë së Transportit “Shpresa AL”, në terminalin e autobusëve, për të shkuar në drejtim të stacionit pranë Institutit Bujqësor. Sërish ka ndodhur e njëjta situatë, ku nuk më është njohur librezat e verbërisë së lëshuar nga Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, si dhe nuk më është njohur nga fatorino as librezat e lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror. Në këto kushte jam detyruar të paguaj biletën: Seria 56/22, nr. 0944073, me vlerën 40 lekë”.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri ose me akronimin KMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

³ Plotësuar ankesa më datë 09.01.2023, nga znj. H. pranë zyrave të KMD-së

⁴ Referuar Librezës së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, nr. 14484, lëshuar 06.04.2018, znj. S. H. është e verbër Grupi II.

Situata e sipër cituar, sipas ankueses nuk i ka ndodhur në çdo rast në të cilin ka udhëtuar në linjën e transportit Tiranë-Kamëz-Tiranë, por në disa raste në varësi të stafit të ndodhur në autobus.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të saj nga ana e Kompanisë së Transportit Urban “Shpresa-Al-Transport” sh.p.k, për shkak të aftësisë së kufizuar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe pe Bazuar në nenin 7 të LMD, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a publikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, apo në raport me të drejtat e tyre ligjore.*

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me situatën diskriminuese të pretenduar dhe kohën kur kishte ndodhur ajo. Për këtë, u mor kontakt⁵ me ankuesen, duke i kërkuar plotësimin e saj. Më datë 09.01.2023, S. H. u paraqit pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe plotësoi mangësitë e ankesës duke depozituar informacion më të qartë sa i përket pretendimeve të paraqitura në ankesë.

Në vijim, në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 95 prot., datë 17.01.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime Bashkisë Kamëz, Kompanisë së Transportit Urban “Shpresa-Al-Transport” sh.p.k dhe Task-Forcës së Transportit Rrugor, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

Në përgjigje përsa më lart, Task-Forca për përmirësimin e nivelit të kontrollit të mjeteve mototrike e rimorkiove të tyre, përmes shkresës⁶ me nr. 93/1 prot., datë 06.02.2023, ka informuar Komisionerin, ndër të tjera se pas marrjes së ankesës janë monitoruar gjatë itinerarit të lëvizjes 2 (dy) autobus të Kompanisë së Transportit Urban “Shpresa-Al-Transport” sh.p.k. dhe nuk ishin konstatuar problematika të natyrës së përmendur nga ana e S. H.. Sipas tyre, nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë së transportit iu është sqaruar se ka patur raste kur invalidët kanë patur librezë të shoqatave, por nuk kanë patur librezën e lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

- Nga ana e Kompanisë “Shpresa-Al-Transport” sh.p.k. dhe Bashkisë Kamëz nuk i është kthyer përgjigje KMD-së, lidhur me sa ka kërkuar me shkresën me nr. 95 prot., datë 17.01.2023.
2. Përsa më lart, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, iu drejtua sërish Kompanisë “Shpresa-Al-Transport” sh.p.k. dhe Bashkisë Kamëz, me shkresën nr. 251 prot., datë 10.02.2023, duke i kërkuar informacionin e cituar në shkresën nr. 95 prot., datë 17.01.2023

Në përgjigje sa më sipërcituar, Bashkia Kamëz me shkresën⁷ nr. 1393 prot., datë 16.02.2023, sqaroi ndër të tjera se: *“Nga shtetasja S. H. në drejtim të Bashkisë Kamëz nuk ka ardhur asnjë ankesë qoftë verbale ashtu edhe shkresore përsa i përket problematikës së diskriminimit në veçanti personave me aftësi të kufizuara.”*, duke bashkëlidhur edhe një kopje të kontratës së transportit, nënshkruar mes Bashkisë dhe Kompanisë “Shpresa-Al” sh. p. k.

Kompania “Shpresa-Al-Transport” sh.p.k. me shkresën⁸ nr. 13 prot., datë 14.02.2023, sqaroi ndër të tjera se: *“Në ushtrimin e aktivitetit të saj, i çfarëdo fushe qoftë, shoqëria jonë ndjek parimin e mbështetjes dhe ndihmës ndaj shtresave më vulnerabel apo në nevojë. Për këtë arsye jo pak herë ajo ka qenë prezente duke dhënë ndihmë konkrete, dhe pa asnjë qëllim reklamimi, për shtresat e varfëra, për fëmijët në nevojë, për familjet e dëmtuara nga tërmeti i nëntorit 2019 etj. Prandaj edhe personat me aftësi të kufizuara janë në fokus të vëmendjes*

⁶ Protokolluar pranë Komisionerit me Nr. 95/1 prot., datë 06.02.2023

⁷ Protokolluar pranë Komisionerit me Nr. 251/2 prot., datë 20.02.2023

⁸ Protokolluar pranë Komisionerit me Nr. 251/1 prot., datë 17.02.2023

tonë për ti ndihmuar dhe krijuar sa më shumë lehtësira. Me gjithë vështirësitë që shoqëritë e transportit po kalojnë, për shkak edhe të rritjes së ndjeshme të çmimit të karburantit, në, këtë kategori personash e mbështesim dhe do të vazhdojmë ta mbështesim, pavarësisht se në kaq vite aktivitet transporti, nuk kemi marrë asnjëherë kompensim për ta, nga shteti.

Ligji Nr.26/2012, datë 15.03.2012 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit” në nenin 11 të tij parashikon: “Të verbrit dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masat, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Neni 85 i ligjit Nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar,) parashikon:

“Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetës...Fondet për kompensimin e tarifës së transportit të kategorive të personave, që përfitojnë nga legjislacioni në fuqi për transportin qytetas, përballohet nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit. Masat, kriteret dhe procedurat për kompensimin e kësaj tarife përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Siç mund të jeni në dijeni, deri më sot nuk është përcaktuar asnjë masë, mënyrë dhe formë kompensimi, si për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar ashtu edhe për shoqëritë që kryejnë veprimtarinë e transportit rrugor, duke krijuar kjo mangësi ligjore, jo në pak raste, edhe përplasje mes këtyre dy kategorive.

Pavarësisht mangësive ligjore dhe duke mbartur mbi vete një kosto financiare të cilën ligjërisht duhet ta mbajë shteti, ne do të vazhdojmë të ofrojmë ndihmesën me të gjitha mundësitë tona, për të mundësuar transportin e personave me aftësi të kufizuar, në veçanti të verbër, bazuar në lehtësirat financiare.

Së fundmi, duke qenë se nuk kemi dijeni për ngjarjen konkrete, nuk kemi as ndonjë sqarim konkret për problematikën, por nga ana e stafit drejtues të aktivitetit të transportit urban, punonjësit tanë janë të udhëzuar që gjatë ushtrimit të punës së tyre të jenë të kujdesshëm dhe sa më shumë mbeshtetës, në veçanti me kategorinë e personave me aftësi të kufizuar.”

3. Komisioneri nëpërmjet shkresës me nr. 251/3 prot., datë 06.04.2023, iu drejtua sërish Bashkisë Kamëz, duke kërkuar prej saj informacionin nëse është miratuar ndonjë akt nënligjor nga ana e Këshillit Bashkiak Kamëz (Bashkia Kamëz), lidhur me subvencionimin e Shoqërisë Shpresa AL, në përmbushje të detyrimeve kontraktuale sipas Kontratës të Shërbimit, të lidhur ndërmjet Bashkisë Kamëz dhe Shoqërisë Shpresa AL, përkatësisht Kontratës nr. 674, datë 15.02.2017, “Për transportin e udhëtarëve në linjën rrethqytetëse “Kamëz- Tiranë- Kamëz⁹” të Bashkisë Kamëz. Bashkisë iu kërkua të depozitonte një kopje të këtij akti, nëse kishte një të tillë, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijani e shkresës së sipërcituar.

⁹ Si dhe Aneks Kontratës me nr. 2020 prot., datë 06.03.2020, bashkëlidhur kësaj Kontrate.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar nëse është miratuar ndonjë akt nënligjor nga ana e Këshillit Bashkiak Kamëz (Bashkia Kamëz), lidhur me subvencionimin e Shoqërisë Shpresa AI, në përmbushje të detyrimeve kontraktuale sipas Kontratës të Shërbimit, është i domosdoshëm për marrjen e një vendimi përfundimtar për çështjen.

Bazuar në nenin 85/3 të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“3. Në ato raste kur informacioni apo dokumentet e kërkuara nga palët janë të domosdoshme për shqyrtimin e pretendimit të ngritur nga vetë palët, procedura pezullohet deri në sigurimin e informacionit dhe palët njoftohen për këtë gjë”.*

4. Bazuar në sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, arriti në përfundimin se, procedurat për shqyrtimin e ankesës nr. 206 Regj., datë 23.12.2022, të S. H., duhet të pezullohen deri në sigurimin e informacionit të kërkuar nga ana e Bashkisë Kamëz, brenda një afati prej 5 (pesë) ditë nga marrja dijani mbi shkresën e sipërcituar. Për këtë me vendimin Nr. 55, datë 11.04.2023, vendosi pezullimin e procedurës administrative, lidhur me shqyrtimin e ankesës nr. 206 Regj., datë 23.12.2022, të S. H., deri në sigurimin e informacionit të kërkuar.

Në përgjigje sa më sipër, Bashkia Kamëz nuk solli asnjë parashtim apo dokumentacion, përse ishte kërkuar nga Komisioneri.

Në këto kushte, duke qenë se nga ana e Bashkisë Kamëz nuk u përcoll informacioni i kërkuar si dhe faktit që përfundoi afati i caktuar për kthimin përgjigjes në vendimin e ndërmjetëm, Komisioneri me vendimin Nr. 74, datë 18. 05. 2023, vendosi ndërprerjen e pezullimit dhe çeljen e procedurës administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 206 Regj., datë 23.12.2022, të Fondacionit “Së Bashku”, pasi u administrua informacioni i kërkuar për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës.

III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

Në ankesën e depozituar nga ana e S. H., pretendohet diskriminimi i saj, (me status të verbëri), nga ana shoqërisë së transportit Shpresa AL.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri evidentoi se Bashkia Kamëz është subjekti i cili licenson shoqëritë e transportit që ushtrojnë aktivitetin qytetas në territorin që ajo mbulon.

Në kontekst të legjitimitetit të subjektit ankues kundrejt subjekteve ndaj të cilëve ka pretenduar diskriminimin, Komisioneri vëren se, bazuar në kompetencat e sanksionuara nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe

aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, Bashkia Kamëz, *gëzon legjitimitet pasiv në këtë proces*, pasi ka tagrin për ofrimin e monitorimin e shërbimit të transportit për kategorinë e të verbërve, nga ana e operatorëve të transportit rrugor, me të cilët ajo hyn në marrëdhënie kontraktuale.

Në këtë kuadër, Komisioneri bëri pjesë të procedurave hetimore dhe këtë njësi të vetëqeverisjes vendore, si subjekt ndaj të cilit shqyrtohet ankesa e paraqitur nga ana e S. H.

Diskrimimi i pretenduar nga S. H. mbështetet në rastin specifik se në linjën e transportit urban të Bashkisë Kamëz, nuk u ofrohet shërbimi i transportit urban qytetas falas, ndërkohë që një gjë e tillë është e parashikuar në legjislacionin përkatës.

Mbështetur në legjislacionin në fuqi¹⁰ që rregullon fushën e transportit, transporti rrugor i udhëtarëve brenda vendit në formën e shërbimit të linjave të rregullta, ndahet në: (1) transport qytetas, (2) transport rrethqytetas¹¹ dhe (3) transport ndërqytetas¹². Transporti qytetas që përbën objektin e kësaj ankese, bën pjesë në kompetencat e pushtetit vendor. Ndërkohë që, transporti ndërqytetas rregullohet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë e transportit. Kjo ndarje e kompetencave sipas llojeve të transportit, ngarkon me përgjegjësi pushtetin qendror dhe atë vendor.

- 1) Me qëllim identifikimin e bazës ligjore që përmban parashikime pozitive, lidhur me përfitimin e transportit falas për kategorinë e personave të verbër, Komisioneri, mori në analizim Ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “*Për Statusin e të Verbërit*” (Ndryshuar me ligjin nr. 26/2012, datë 15.03.2012). Referuar dispozitave të ligjit të sipërpërmendur, rezultoi se, fillimisht neni 11, i këtij ligji parashikonte shprehimisht: “*Të verbërit kanë të drejtë që ata vetë dhe shoqëruesit e tyre të udhëtojnë falas në transportin urban, dhe me gjysmë çmimi në transportin interurban, duke përfshirë atë shtetëror dhe privat.*”

Në vijim, neni 11, i ligjit të sipërpërmendur është ndryshuar, nëpërmjet ligjit nr. 26/2012, datë 15.03.2012 “*Për disa ndryshime në ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit*”. Aktualisht, ky nen parashikon: “*Të verbërit dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*”

Sikurse vihet re nga sa më sipër, pas ndryshimeve, që i janë bërë në vitin 2012, Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “*Për Statusin e të Verbërit*” (i ndryshuar), personat e verbër nuk përfitojnë më transport qytetas/urban¹³ falas dhe transport interurban¹⁴/ndërqytetas me 50% të

¹⁰ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “*Për transportet rrugore*” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

¹¹ Transporti rrethqytetas nuk bën pjesë në objektin e shqyrtimit të kësaj ankese.

¹² Transporti ndërqytetas nuk bën pjesë në objektin e shqyrtimit të kësaj ankese.

¹³ Terminologji e përdorur në këto ligje;

vlërës së biletës. Me ndryshimet ligjore, kjo kategori do të përfitojë kompesim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është miratuar ende.

Edhe legjislacioni i miratuar në fushën e transportit përmban parashikime të përgjithshme mbi lehtësitë, që duhet të përfitojnë në shërbimin e transportit urban qytetas, për shtresat dhe kategoritë vulnerabël, por gjithmonë duke kryer referencën përkatëse, në ligjet e posaçme për secilën kategori. Për sa më sipër, neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar)¹⁵ parashikon:

“Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjjes për ta.

Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta.

Fondet për kompensimin e tarifës së transportit të kategorive të personave, që përfitojnë nga legjislacioni në fuqi për transportin qytetas, përballohet nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit. Masa, kriteret dhe procedurat për kompensimin e kësaj tarife përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Për sa më sipër, edhe neni 85, i ligjit 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, ka vendosur detyrimin dhe ka autorizuar nxjerrjen e një akti nënligjor nga ana e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të përcaktojë, masat, kriteret dhe procedurat për kompesimin e tarifës së transportit qytetas për udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta. Ky akt nënligjor nuk rezulton të jetë miratuar.

Në referencë të akteve nënligjore të miratuara në fushën e transportit, Komisioneri është fokusuar edhe në parashikimet e Vendimit nr. 85, datë 08.02.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”, ku është përcaktuar se të drejtën për të përcaktuar çmimet e biletave për

¹⁴ Terminologji e përdorur në këto ligje;

¹⁵ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar me ligjin nr. 10/2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 37/2014 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 21/2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 10 302, datë 15.07.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9760, datë 21.06.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9373, datë 14.04.2005, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9096, datë 03.07.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ndryshuar me ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002”, ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”).

kategoritë që përfitojnë lehtësira në transportin qytetas/rrethqytetas me ligje të veçanta, e kanë, këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë qëllim. Pika 7, e Vendimit nr. 85, datë 08.02.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor” parashikon: “Për udhëtarët, që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, çmimi i biletave për transportin qytetas dhe rrethqytetas caktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë qëllim, me vendim të këshillit të njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Në referencë të Udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016, të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, Bashkitë janë organet kompetente për lëshimin e licencave dhe certifikatave për operatorët e shërbimit urban qytetas.

Në vijim, vlen të përmendet edhe Udhëzimi nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “Mbi modelet dhe standartet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”. Ky udhëzim bën një identifikim të grupeve, që përfitojnë lehtësira financiare në marrjen e shërbimeve publike në përputhje me kuadrin ligjor, por jo llojin e lehtësirave që përfitojnë. Personat që u përkasin kategorive apo grupeve në fjalë, pajisen me *Kartat standarde të personalizuar*. Në pikën 5.3.2.1, 5.3.2.2 dhe 5.3.2.4 përcaktohen si të tillë: invalidët e punës, të verbërit dhe invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Në pikën 5.3.2.6, të Udhëzimit nr. 3743/2017, parashikohet si përfitues edhe çdo subjekt ose kategori që mund të përfitojë në vijim, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, rezulton se personat me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin e të verbërit gëzojnë lehtësira në shërbimin e transportit, duke përfshirë këtu të treja format e transportit me linja të rregullta, pra transport qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas. Transporti qytetas dhe rrethqytetas, janë kompetencë e pushtetit vendor. Referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, pushteti vendor ka kompetencën për të përcaktuar linjat, për të liçensuar subjektet dhe për të përcaktuar çmimin e biletave për kategoritë që përfitojnë lehtësira në transport. Kjo kategori është përfituese e kompesimit, i cili nuk është përcaktuar akoma në çfarë mase, si dhe nuk janë përcaktuar kriteret për përfitimin e tij, pasi nuk është miratuar ende akti nënligjor, që duhet të bëjë përcaktime të tilla.

Nga dokumentacioni dhe informacioni i administruar në kuadër të një ankese të mëparshme pranë Komisionerit¹⁶, rezulton se problematika e mospërfitimit të lehtësirave në transportin urban qytetas është një problematikë e parashtruar sipas informacionit të dhënë nga Shoqata e Transportit Urban dhe Interurban Kamëz Veri dhe Shoqata “Shpresë për të verbërit”. Sipas tyre, ata kanë depozituar disa kërkesa dhe ankesa, pranë MIE-së dhe MSHMS-së, por edhe në institucione e dikastere të tjera të pushtetit vendor, lidhur me sigurimin e lehtësirave në transportin publik qytetas.

¹⁶ Referuar ankesës nr. 19, datë 19.02.2021, të K. M dhe Shoqatës “Shpresë për të verbërit”, ku pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, nga ana e Shoqërisë Shpresa-Al sh.p.k.

Nisur nga problematika e paraqitur nga Shoqata në mbrojtje të interesave të personave me aftësi të kufizuara, Ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë i është drejtuar, nëpërmjet shkresës¹⁷ nr. 3129, datë 28.05.2014, të gjithë Kryetarëve të Bashkive dhe për dijeni Prefektëve të Qarqeve, ku nisur nga problematika e paraqitur nga shoqatat e invalidëve të punës, lidhur me sigurimin e lehtësive në transportin urban për këtë kategori, i udhëzon titullarët e këtyre institucioneve, si vijon:

“Aktualisht, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë është në procesin e vlerësimit dhe të hartimit të projektvendimeve për përcaktimin e mënyrës së kompensimit të shërbimit të transportit për kategoritë që përfitojnë lehtësira në transport sipas legjislacionit në fuqi. E drejta e invalidëve të punës për udhëtimin falas në mjetet e komunikacionit qytetas privat është e përcaktuar edhe në dokumentacionin liçencues dhe certifikues të shoqërive të transportit.....Duke qenë se autoritetet përgjegjëse për lëshimin e këtyre liçencave janë njësitë e qeverisjes vendore, ato duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për plotësimin e detyrimeve të parashikuara në liçencë për subjektet që kryejnë transport rrugor. Në rast të kundërt mund të kërkojnë heqjen e liçencës për subjektet që nuk i përmbushin këto detyrime. Nga sa më lart, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë kërkon zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, si dhe detyrimeve që kanë shoqëritë e transportit bazuar në dokumentacionin e tyre liçencues dhe certifikues, në lidhje me të drejtën e invalidëve të punës për udhëtim falas me mjetet e komunikacionit qytetas privat. Gjithashtu kërkojmë vëmendjen e njësisive të qeverisjes vendore në mbikqyrjen e vazhdueshme të respektimit të detyrimeve kontraktuale mbi këtë të drejtë të invalidëve të punës nga shoqëritë e transportit”.

Për sa më sipër, rezulton se pavarësisht mungesës së aktit nënligjor, i cili do të përcaktojë masën, kriteret dhe procedurat e kompensimit të shërbimit të transportit për kategorinë e të verbërve dhe vonesës së zgjatur për nxjerrjen dhe miratimin e këtij akti nënligjor, ministri përgjegjës i ka dhënë një zgjidhje të përkohëshme çështjes në fjalë, duke mos cënuar të drejtën e invalidëve të punës, sikurse për analogji edhe kategorisë së personave të verbër, për të gëzuar lehtësi në transportin urban qytetas. Për të realizuar një shërbim të tillë, në mungesë të aktit nënligjor ende të pamiraturar, ai udhëzon që njësitë e qeverisjes vendore në zbatim të kompetencave që atyre u atribuon legjislacioni në fuqi, të mbikqyrin në mënyrë të vazhdueshme respektimin e detyrimeve kontraktuale nga ana e operatorëve të shërbimit urban, si dhe u kujton këtyre njësisive se e drejta e transportit falas të kategorive të personave me aftësi të kufizuara është e përcaktuar në dokumentacionin liçencues dhe certifikues të shoqërive të transportit, ku këto të fundit lëshohen nga organet e qeverisjes vendore.

- 2) Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri analizoi edhe përmbajtjen e Kontratës të Shërbimit, të lidhur ndërmjet Bashkisë Kamëz dhe Shoqërisë Shpresa AL, përkatësisht Kontratës nr. 674, datë 15.02.2017, “Për transportin e udhëtarëve në linjën rrethqytetëse “Kamëz -Tiranë- Kamëz 2¹⁸” të Bashkisë Kamëz.

¹⁷ Administruar në çështjen e trajtuar nga KMD me Nr. 192 rregj., datë 18.12.2018, të Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Shkodër.

¹⁸ Si dhe Aneks Kontratës me nr. 2023 prot., datë 06.03.2020, bashkëlidhur kësaj Kontrate.

Kontrata e mësipërme ka prodhuar efekte për palët kontraktuale që nga data e nënshkrimit të saj, me datë 15.02.2017, efekte të cilat kanë një shtrirje kohore 10 vjeçare, pra deri më datë 15.02.2027.

Neni 9, i kontratës së sipërcituar parashikon shprehimisht: “Kontraktori detyrohet që të garantojë udhëtimin e të gjithë kategorive të udhëtarëve që sipas legjislacionit në fuqi që përfitojnë lehtësira në udhëtim, si: Udhëtimi me bileta pajtimi (abone), udhëtimin pa pagesë kundrejt paraqitjes së dokumentit që parashikon ligji për to, etj.”

Neni 10, përcakton se: “Kontraktori merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në linjën përkatëse, të përmbushë detyrimin sipas nenit 8 dhe 9 të cituar më lart, kundrejt subvencionit të kontratës, vetëm pas miratimit në Këshillin Bashkiak të financimit të subvencioneve (miratimi i planifikimit në Buxhetin e Bashkisë ose me VKM).”

Për sa më sipër, rezulton se Shoqëria Shpresa AL, me të cilën Bashkia Kamëz ka lidhur kontratë shërbimi, ka detyrim kontraktual ofrimin e shërbimit urban qytetas falas për kategorinë e personave të verbër.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se Bashkia Kamëz ka patur të gjitha mundësitë për të mos e lënë të thellohej problematika e mosofrimit të shërbimit të transportit urban falas, jo vetëm për subjektin ankues dhe kategorinë e të verbërve, por edhe për kategoritë e tjera të parashikuara në nenin 9, të kontratës së shërbimit, të lidhur me operatorin e shërbimit urban Shpresa AL.

Përveç sa më sipër, Bashkia Kamëz, në cilësinë e autoritetit që lëshon licencat dhe certifikatat për operatorët e shërbimit urban, në referencë të pikës 4, të Lidhjes 4, së Udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016, të Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, ku parashikohet se:

“Mbajtësi i liçencës dhe i kësaj çertifikate mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve nr.7889/94, të ndryshuar, nr. 7663/93, nr. 8626/00, të ndryshuar në të cilat përcaktohet:

a) Për transportin qytetës: - “invalidët e punës, invalidët e luftës, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët nga organizatat përkatëse janë të pajisur me dëshmi, kanë të drejtë të udhëtojnë falas”, si dhe për zbatimin e ligjeve nr. 8098/96, nr. 8153/96, të ndryshuar; -“të verbërit e shoqëruesit e tyre dhe jetimët që nuk janë në marrëdhënie pune, udhëtojnë falas”; duhej të kishte vepruar menjëherë kundrejt moszbatimit të këtij udhëzimi.

Problematika e parashtruar nga pala ankuese, sa i përket transportit urban qytetas, është një fakt i bërë publik që nga viti 2012, kur janë miratuar ndryshimet në ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit” apo edhe ligjeve të tjera të cilat kanë prekur kategori si: invalidët para dhe tetraplegjik etj. Në këtë kuadër, Shoqata Kombëtare e të Verbërve të Shqipërisë, ka kërkuar

publikisht¹⁹ në vijimësi, për gjetjen e një zgjidhje për kategorinë e të verbërve, sa i përket transportit.

Nga informacioni i administruar nga Komisioneri në kuadër të ankesave të mëparshme me të njëjtin objekt, kundër Bashkisë Kamëz, Bashkia ka qenë në dijeni të situatës së krijuar ndërmjet operatorit të transportit publik Shpresa AL dhe kategorive të personave që përfitojnë udhëtimin pa pagesë në territorin e saj, në përgjithësi dhe specifikisht edhe të rastit konkret me shtetasen S. H. (për problematikën e të cilës është vënë në dijeni nga Komisioneri që me datë 17.01.2023). Pavarësisht kësaj, nuk rezulton të ketë pasur përpjekje nga ana e Bashkisë për verifikimin e problematikës me ankuesen, apo rregullimin përfundimtar të situatës, duke mohuar të drejtën e saj për të përfituar lehtësira në udhëtim, si dhe duke shkelur njëherësh edhe detyrimet e saj kontraktuale me shoqërinë e transportit.

Gjithashtu, Bashkia Kamëz, nuk provoi para Komisionerit:

- Që ka miratuar ndonjë akt nënligjor nga ana e Këshillit Bashkiak Kamëz (Bashkia Kamëz), lidhur me subvencionimin e Shoqërisë Shpresa AL, në përmbushje të detyrimeve kontraktuale sipas Kontratës të Shërbimit, të lidhur ndërmjet Bashkisë Kamëz dhe Shoqërisë Shpresa AL, përkatësisht Kontratës nr. 674, datë 15.02.2017, “Për transportin e udhëtarëve në linjën rrethqytetëse “Kamëz -Tiranë- Kamëz” të Bashkisë Kamëz, duke shkelur këtë të fundit.
- Që kishte marrë masa apo kishte kryer veprime konkrete për të kryer ndonjë kontroll a monitorim për sa i përket respektimit të kontratës së shërbimit të lidhur me këtë Shoqëri.

Në përfundim, Komisioneri gjykon se me anë të veprimeve apo mosveprimeve të saj, Bashkia Kamëz ka ekspozuar subjektin ankues, S. H., e cila bën pjesë në kategorinë e personave të verbër, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, sa i përket transportit urban qytetas pa pagesë.

- 3) Lidhur me pretendimin e subjektit ankues për diskriminim të tij nga ana e Shoqërisë Shpresa AL, pas analizimit të fakteve, provave e dokumentacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht mungesës së aktit nënligjor, i cili do të përcaktojë masën, kriteret dhe procedurat e kompensimit të shërbimit të transportit për kategorinë e të verbërve dhe vonesës së zgjatur për nxjerrjen dhe miratimin e këtij akti nënligjor, ministri përgjegjës i ka dhënë një zgjidhje të përkohëshme çështjes në fjalë, duke mos cënuar të drejtën e invalidëve të punës, sikurse për analogji edhe kategorisë së personave të verbër, për të gëzuar lehtësi në transportin urban qytetas.

¹⁹ <https://www.balkanweb.com/shteti-u-ka-borxh-nga-2-mln-leke-te-verbrit-nenshkruajne-peticion/>
<http://www.respublica.al/arkiv-lajme-të-përditësuara/të-verbërit-në-protestë-kundër-ndryshimit-të-statusit>

Për të realizuar një shërbim të tillë, në mungesë të aktit nënligjor ende të pamiruar, ai udhëzon që njësitë e qeverisjes vendore në zbatim të kompetencave që atyre u atribuon legjislacioni në fuqi, të mbikqyrin në mënyrë të vazhdueshme respektimin e detyrimeve kontraktuale nga ana e operatorëve të shërbimit urban, si dhe u kujton këtyre njësitë se e drejta e transportit falas të kategorive të personave me aftësi të kufizuar është e përcaktuar në dokumentacionin licencues dhe certifikues të shoqërive të transportit, ku këto të fundit lëshohen nga organet e qeverisjes vendore.

Në këtë këndvështrim, nisur nga analizimi i detyrimeve kontraktuale, të parashikuara në kontaktin nr. 674, datë 15.02.2017, “Për transportin e udhëtarëve në linjën rrethqytetëse “Kamëz-Tiranë- Kamëz”, lidhur mes palëve Bashkia Kamëz dhe Shoqëria Shpresa AL, Komisioneri vlerëson se, detyrimi për të ofruar falas shërbimin urban qytetës për kategorinë e personave të verbër²⁰ nga ana e Shoqërisë Shpresa AL është i kushtëzuar nga përmbushja e detyrimit të Bashkisë për ta subvencionuar atë.

Përsa kohë Bashkia nuk ka zbatuar detyrimin e saj për të subvencionuar Shoqërinë, ajo nuk mund të ngarkohet me detyrimin për të ofruar një shërbim të tillë. Në këtë këndvështrim, Komisioneri gjykon se, Shoqëria nuk ka kryer veprime të cilat bien ndesh me zbatimin e kontratës së mësipërme nënshkruar mes saj dhe Bashkisë.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se nga ana e Shoqërisë Shpresa AL, me veprime apo mosveprime të saj, nuk janë shkelur dispozitat e LMD-së. Përkundrazi, Komisioneri ka konstatuar se është Bashkia Kamëz që me mosveprimet e saj ka ndikuar që subjektit ankues dhe gjithë kategorisë së personave që si ai janë pjesë e kategorisë së personave të verbër²¹ t’u mohohet e drejta e udhëtimit falas në transportin urban qytetës.

- 4) Lidhur me pretendimin e subjektit ankues sa i përket veprimeve nga ana e punonjësit/faturinos të transportit publik të Shoqërisë Shpresa AL.

Nga informacioni i administruar, subjekti ankues ka pretenduar se, në momentin që ka paraqitur pranë punonjësit (faturinos) të Shoqërisë Shpresa AL librezën e verbërisë të lëshuar nga Shoqata “Shpresë për të verbërit”, nga ana e këtij të fundit, i është sqaruar se ajo nuk njihet nga shoqëria e transportit dhe për këtë arsye i duhet të paguante biletën e plotë të transportit. Sipas ankueses, punonjësit e Shoqërisë Shpresa AL e kanë bërë me dije se vetëm librezat e lëshuara nga Shoqata e Invalidëve të Punës janë dëshmi zyrtare dhe jo ajo e Shoqatës “Shpresë për të verbërit”.

Lidhur me këtë pretendim të ankueses, Komisioneri gjykon se, këto dy kategori personash me aftësi të kufizuar: ato me status të verbëri dhe ato me status invalid pune, përfitojnë lehtësira

²⁰ Vërtetuar nga dëshmia përkatëse që është Libreza e Verbërisë lëshuar nga SHSSH.

²¹ Vërtetuar me dokumentacionin përkatës.

lidhur me transportin urban, sipas parashikimeve ligjore përkatëse që rregullohen në ligjin specifik të secilës kategori.

Kështu, ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës”, i ndryshuar, në nenin 4, të tij ka përcaktuar se:

“Invalidët paisen me dëshmi zyrtare identifikimi. Dëshmia lëshohet nga Shoqata e Invalidëve të Punës në bazë të KMCAË”.

Pra, bazuar në ligjin sipërcituar, autoriteti përgjegjës dhe zyrtar për paisjen e invalidit të punës me dëshminë zyrtare të identifikimit është Shoqata e Invalidëve të Punës, kompetencë që i buron drejtpërdrejtë nga ligji.

Lidhur me lehtësirat dhe të drejtën e personave me statusin e të verbërit, për të udhëtuar me gjysëm bilete në transportin urban ndërqytetas, neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar)²² parashikon se:

“Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashhtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjjes për ta.

Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të vecanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta”.

Bazuar në sa më sipër, ligji ua njeh këtë të drejtë të gjithë personave me statusin e të verbërit, konform detyrimit për të paraqitur në çdo rast udhëtimi *dokumentin provues specifik*.

Në këtë kontekst, Komisioneri ka analizuar se cila shkresë konsiderohet *dokument provues*, sipas përcaktimeve ligjore përkatëse.

VKM nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar, në pikën 3 dhe 10, të tij ka parashikuar se:

“3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror i lëshon personit të verbër librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitim nga ligji nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë.

²² Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar me ligjin nr. 10/2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 37/2014 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 21/2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 10 302, datë 15.07.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9760, datë 21.06.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9373, datë 14.04.2005, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9096, datë 03.07.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ndryshuar me ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002”, ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”).

Modeli i librezës së verbërisë përcaktohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

.....

10. Udhëtimi në transportin e brendshëm shtetëror dhe privat për personat e verbër behet me 0% te tarifave për transportin urban dhe 50% te tarifave për transportin interurban. Këtë tarifë e përfiton edhe shoqëruesi i te verbrit të grupit të parë”.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar, autoriteti përgjegjës dhe zyrtar për paisjen e personave të verbër me dëshminë zyrtare të identifikimit, librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë, është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror.

Kontrata e Shërbimit nr. 674, datë 15.02.2017, “Për transportin e udhëtarëve në linjën rrethqytetëse “Kamëz -Tiranë- Kamëz”²³ të Bashkisë Kamëz, në nenin 9, parashikon shprehimisht: “Kontraktori detyrohet që të garantojë udhëtimin e të gjithë kategorive të udhëtarëve që sipas legjislacionit në fuqi që përfitojnë lehtësira në udhëtim, si: Udhëtimi me bileta pajtimi (abone), udhëtimin pa pagesë kundrejt paraqitjes së dokumentit që parashikon ligji për to, etj.”

Në këtë kontekst, bazuar në sa më sipër, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjekti ankues Shoqata Kombëtare “Shpresë për të verbërit”, lidhur me pretendimin e njohjes si dokument zyrtar të ligjshëm të Librezë së Verbërisë së lëshuar prej tyre, është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me Shoqatën e Invalidëve të Punës, do të duhej që fillimisht ata të ishin në kushte të njëjta me të.

Për rrjedhojë, në situatën e analizuar më sipër (parashikimet ligjore për legjitimitimin e autoriteteve përgjegjëse kompetente për lëshimin e dokumentit zyrtar të identifikimit të paafëtisë) rezulton qartë që subjekti ankues, Shoqata Kombëtare “Shpresë për të verbërit”, nuk ndodhet në kushte të njëjta me Shoqatën e Invalidëve të Punës, dhe për rrjedhojë, nuk mund të krahasohet me të, dhe në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se nuk mund të pretendohet për trajtim të pabarabartë apo të pafavorshëm krahasimisht me të.

Në mungesë të këtij trajtimimi, bie poshtë edhe pretendimi për diskriminim, i cili në thelb do të duhet të kishte pikërisht konstatimin e trajtimit të pabarabartë apo të pafavorshëm me “krahasuesin”, të lidhur domosdoshmërisht me “shkakun” e pretenduar. Rrjedhimisht, Komisioneri gjykon se nuk kemi shkelje të dispozitave ligjore të LMD-së.

²³ Si dhe Aneks Kontratës me nr. 2023 prot., datë 06.03.2020, bashkëlidhur kësaj Kontrate.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2²⁴, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e subjektit ankues për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, Komisioneri gjykon se ky shkak konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme/dokumente, që e justifikojnë si të tillë.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “aftësinë e kufizuar”.

Kushtetuta është akti më i lartë juridik, ligji më i lartë (lex superior), në pajtueshmëri me të cilin duhet të jenë të gjitha aktet e tjera juridike.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë

²⁴“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo forme sjelljeje që nxit diskriminim.”

në themel të të gjithë rendit juridik". Neni 18, i saj shpreh se: *"Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit"*.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se:

"Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta", si dhe "Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë." (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese).

Në nenin 59, shkronjat e) dhe f) të saj, Kushtetuta ka parshikuar se:

"Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;

f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës".

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor²⁵.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (*e njohur ndryshe edhe si "e drejta konventore"*) ka një vend të posaçëm.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se:

²⁵ Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, duke mos parashikuar një të drejtë të veçantë në lidhje me aksesueshmërinë, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: “a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet²⁶. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme²⁷. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe

²⁶ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

²⁷ Shih: *Çështja Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

domethënëse të ndryshme²⁸. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14, nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar "pabarazitë faktike" ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14²⁹.

Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”³⁰ në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: “Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.”

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, i cili ka si qëllim, të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri.

Persona me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, janë, personat që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

Jetesa e pavarur, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Ligji nr. 93/2014, përcakton se, një nga aspektet që siguron jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara është edhe *transporti*. Në gjurmën “ë”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 93/2014, parashikohet se: “*Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht:ë) në transport....*”. Sipas nenit 6, të ligjit nr. 93/2014, *jetesa e pavarur*, mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave. Në këto shërbime përfshihen ndër të tjera edhe *transporti*.

²⁸Shih: Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

²⁹ Shih: Çështjen *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen *Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; Çështjen *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

³⁰Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

Sikurse është përmendur edhe në rubrikat e sipërpërmendura, njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për transportin urban qytetas. Në pikën 6, të nenit 23 “*Funksionet e Bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike*”, të ligjit nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” parashikohet: “*Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:6. Transportin publik vendor*”.

Në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 93/2014, përcaktohet: “*Aksesueshmëri*” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve”. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se:

“ 3. “*Pengesat*” nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar; c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.”

Në përputhje me qasjen e KDPAK edhe ky ligj sanksionon se garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimi të pengesave të të gjitha llojeve është një nga parimet e këtij ligji (neni 3/ç) dhe se jetesa e pavarur e personave me aftësi të kufizuar mund të sigurohet nëpërmjet garantimit të aksesueshmërisë, përfshirë aksesin në të gjitha shërbimet publike.

Ligji “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, është një ligj i cili është miratuar në bazë dhe në zbatim të nenit 18, të Kushtetutës. Në bazë të LMD, jo çdo diferencë në trajtim, konsiderohet diskriminim. Neni 6, i LMD, përcakton: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”.

Sipas nenit 3, pika 1 të LMD, “*Diskriminimi*” përkufizohet si: “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi*”.

Në pikën 1, të nenit 5, të LMD, sanksionohet ndalimi i diskriminimit, sipas formulimit vijues: “*1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.*”

Në Kreun IV, të LMD, parashikohet një mbrojtje të posaçme nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve. Konkretisht, në nenin 20, pika 1, dhe pika 2, shkronjat “a” dhe “ë”, të LMD parashikohet:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi. 2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: a) mundësi për të hyrë në një vend ku publiku lejohet të hyjë ose për të përdorur një vend, i cili lejohet për t’u përdorur nga publiku;”

Parimi i ndarjes së barrës së provës është evidentuar tashmë në ligjin e BE dhe KEDNJ. KEDS³¹ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Një qasje e ngjashme gjendet në kuadrin e Komitetit Evropian të të Drejtave Sociale të Këshillit të Evropës (*organi mbikëqyrës i Kartës Sociale Evropiane*), i cili gjithashtu u shpreh se ligji vendas, kombëtar duhet të sigurojë një lehtësim të barrës së provës në favor të paditësit në rastet e diskriminimit. Në të vërtetë, siç thuhet në Përmbledhjen e praktikës gjyqësore të Komitetit Evropian të të Drejtave Sociale dhe gjithashtu thuhet nga GJEDNJ në çështjen në fjalë, barra e provës nuk duhet të jetë tërësisht mbi palën kërkuese dhe duhet të jetë objekt i një rregullimin e duhur në rast të diskriminimit.

Bazuar në nenin 33, pika 7/1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka

³¹ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë një të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.³²

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që personat me aftësi të kufizuara, subjekti ankues, nuk ka përfituar nga transporti urban në linjën e ofruar nga operatori Shpresa AL. Nga ana e Bashkisë Kamëz nuk është vënë në dispozicion asnjë informacion apo provë lidhur me hapat e ndërmarrë për zgjidhjen e kësaj situatë konkrete dhe as në vijimësi.

Në analizë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga Bashkia Kamëz, kundrejt subjektit ankues, si person me aftësi të kufizuara, e verbër dhe si pasojë barra e provës bie mbi këtë subjekt. Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, Bashkia Kamëz duhet të përmbushë dy kushtet e përmendura më sipër.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Bashkia Kamëz nuk rezulton të ketë kryer asnjë përpjekje me pushtetin qendror për t'i dhënë një zgjidhje përfundimtare situatës, në lidhje me përcaktimin e masave, kritereve dhe procedurat për kompesimin e tarifës së transportit qytetas për udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta;
- Bashkia Kamëz ka pasur të gjithë mundësinë për zgjidhjen vetë të situatës konkrete, nisur nga fakti që transporti qytetas është funksion i saj, ekskluziv, për t'ia garantuar të gjithë banorëve të saj³³, duke garantuar përkujdesje sociale të veçantë për personat me aftësi të kufizuara³⁴. Pikërisht në funksion të faktit, që transporti qytetas është funksion ekskluziv i Bashkisë, Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 "*Për transportet rrugore*", i ndryshuar, në nenin 10, shkronja c)³⁵, të tij parashikon edhe vendosjen e tarifës së shërbimit urban nga vetë Bashkia. Gjithashtu, neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "*Për transportet rrugore*", i ndryshuar, parashikon se fondet për kompensimin e transportit qytetas përballohen nga Bashkitë;
- Bashkia Kamëz nuk depozitoi prova/dokumentacion shkresor që ka miratuar ndonjë akt nënligjor, lidhur me subvencionimin e Shoqërisë Shpresa AL, në përmbushje të detyrimeve kontraktuale sipas Kontratës të Shërbimit, të lidhur ndërmjet Bashkisë Kamëz dhe Shoqërisë Shpresa AL, përkatësisht Kontratës nr. 674, datë 15.02.2017,

³² https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

³³ Në referencë të neneve 22 dhe 23, të Ligjit nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*".

³⁴ Në referencë të nenit 24, të Ligjit nr. 139/2015. "*Për vetëqeverisjen vendore*".

³⁵ Neni 10, shkronja c), i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "*Për transportet rrugore*" (i ndryshuar) parashikon: "*Tarifat e biletave të transportit qytetas të udhëtarëve me autobus miratohen me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, sipas nenit 14 të këtij ligji.*".

“Për transportin e udhëtarëve në linjën rrethqytetëse “Kamëz-Tiranë-Kamëz”³⁶” të Bashkisë Kamëz, duke shkelur këtë të fundit

Njëkohësisht, vlen të theksohet fakti se para vitit 2014, ka ekzistuar një ndarje diskriminuese në legjislacionin shqiptar, në lidhje me përfitimin e lehtësirave për përfitimin e shërbimeve, duke trajtuar ndryshe dhe në mënyrë të padrejtë, kategori të ndryshme PAK, në situata thelbësisht të ngjashme.

Kjo problematikë është ndrequr me miratimin e Ligjit 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”*, i cili mbështetur edhe në Konventa e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*, eliminon çfarëdo lloji diferencimi në thelb të aftësisë së kufizuar dhe garantimit të lehtësirave për të gjithë personat me aftësi të kufizuar. Në këtë këndvështrim, diferencimi midis invalidëve të punës, të cilët sipas ligjit të posaçëm përfitojnë transport falas dhe personave të verbër, të cilët marrin kompensim, jo vetëm që është i padrejtë dhe diskriminues, por tashmë është i tejkaluar dhe të njëjtat garanci, që ofrohen për një kategori duhen garantuar edhe për kategoritë e tjera. Nisur nga fakti që ofrimi i shërbimit të transportit për personat me aftësi të kufizuar, realizohet në mënyrën më të plotë dhe të thjeshtë duke e garantuar atë falas, kjo duhet të ndodhë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar, pa asnjë lloj dallimi apo diferencimi.

Për këtë arsye, mosnxjerrja e akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave, që në vetvete përbën një mosveprim shumë të rëndë, nuk mund të shërbejë si pengesë për Bashkinë Kamëz për zgjidhjen përfundimtare të situatës, pasi rendi juridik i ofron të gjitha mundësitë, që transportin falas, Bashkia mund dhe duhet ta garantojë vetë, si duke nxjerrë aktet e nevojshme normative, ashtu edhe duke bërë parashikimet për përfitimin e shërbimit falas për personat me aftësi të kufizuar. Lidhur me këtë, Bashkia në nenin 10 të kontratës së lidhur me operatorin e shërbimit Shpresa AL, ka cituar se: *“Kontraktori merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në linjën përkatëse, të përmbushë detyrimin sipas nenit 8 dhe 9 të cituar më lart, kundrejt subvencionit të kontratës, vetëm pas miratimit në Këshillin Bashkiak të financimit të subvencioneve”*.

Ndërkaq, nga analizimi i Kontratës së Shërbimit, që Bashkia Kamëz ka lidhur me operatorin e shërbimit urban qytetas, rezulton se në nenin 9 dhe 10, ka parashikime të sakta lidhur me detyrimin e operatorëve urban, për të ofruar transport falas për kategorinë e personave që përfitojnë lehtësira në udhëtim, si: udhëtimin pa pagesë kundrejt paraqitjes së dokumentit që parashikon ligji për to etj.

Komisioneri vlerëson se nga ana e Bashkisë Kamëz nuk u arrit të provohej:

³⁶ Si dhe Aneks Kontratës me nr. 2023 prot., datë 06.03.2020, bashkëlidhur kësaj Kontrate.

1. Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga ankuesi, që është aftësia e kufizuar dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë nga ana e Bashkisë Kamëz, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.
2. Që veprimet dhe mosveprimet e saj kundrejt ankuesit dhe personave që ndodhen në kushte të njëjta me të, kanë një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se Bashkia Kamëz nuk ka vepruar në bazë të kompetencave, që asaj i atribuohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të ndaluar faktin e mos ofrimit të lehtësirave në transport për kategorinë e të verbërve, si dhe për rregullimin e situatës në mënyrë përfundimtare. Komisioneri vëren se, Bashkia Kamëz ka dështuar në marrjen e masave për heqjen e të gjitha pengesave institucionale, për të krijuar të gjitha lehtësitë për garantimin e transportit qytetas për personat me aftësi të kufizuar, të verbër.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, subjektit ankues dhe kësaj kategorie personash me aftësi të kufizuara, sikurse edhe të gjitha kategorive të tjera që bëjnë pjesë në këtë grupim, u është mohuar një e drejtë, e cila u është dhënë nga legjislacioni në fuqi.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se Bashkia Kamëz, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të saj, ka vendosur përpara një situatë diskriminuese, për shkak të aftësisë së kufizuar, ankuesen sa i takon ofrimit të transportit pa pagesë të parashikuar në legjislacionin e sipërpërmendur.

Të njëjtin qëndrim, për një çështje të ngjashme ka mbajtur Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kur me Vendimin nr. 146, datë 06.08.2021 dhe Vendimin nr. 174, datë 20.09.2021, të tij, ka konstatuar diskriminimin e kategorisë së personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe atyre të verbër, nga ana e Bashkive respektive, për shkak të aftësisë së kufizuar.

Gjithashtu, Komisioneri me anë të shkresës Nr. 953 prot., datë 12.06.2019, i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me: *“Rekomandim mbi rishikimin/plotësimin e legjislacionit që lidhet me lehtësirat në transport dhe përfitimin në baza të barabartë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara”*.

Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t’u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, si dhe mundësisht t’u garantohet jetesa e pavarur dhe me lehtësirat e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025³⁷, citon ndër të tjera se:

“Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar (PKVPAK) 2021-2025, është një dokument ndërsektorial i qeverisë shqiptare që përfshin politika të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara e që do të hidhen për zbatim gjatë 5 vjecarit të ardhshëm. Qëllimi i tij është të vazhdojë promovimin dhe mbështetjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në jetën social-ekonomike të vendit duke patur në vëmendje të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve të KDPAK përmes masave specifike.

Procesi i hartimit të këtij dokumenti përputhet edhe me një moment tjetër të rëndësishëm të zbatimit të politikave për aftësinë e kufizuar në Shqipëri në funksion të realizimit të parimeve të KDPAK, të ratifikuar nga shteti shqiptar.

Qëllimi, objektivat specifike dhe masat e parashikuara në këtë plan për realizimin e aksesueshmërisë, adresojnë reduktimin e barrierave për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim: (i) sigurimin e aksesit në të mirat materiale, shërbimet dhe lehtësirat; (ii) sigurimin dhe mbajtjen e vendit të punës; (iii) përfshirjen dhe pjesëmarrjen në komunitet; (iv) ndryshimet në sjelljet, qëndrimet dhe veprimet, të cilat diskriminojnë personat me aftësi të kufizuara.

Politika orienton institucionet publike në masat që ato duhet të marrin për realizimin e aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në: (i) mjedise; (ii) transport; (iii) informacion e komunikim”.

Ky dokument thekson faktin se, qeveria është e angazhuar të administrojë në mënyrë aktive çështjen e aftësisë së kufizuar në Shqipëri duke përditësuar gjithmonë e më shumë të drejtat e PAK në politikat e saj sektoriale.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Bashkia Kamëz nuk vendosi në dispozicion asnjë informacion në lidhje me masat konkrete, afatet kohore dhe fondet, (apo hartimin e një plani konkret të mirëfilltë) për detyrimin e Shoqërisë së transportit rrugor me të cilën ka nënshkruar një kontratë me afat kohor 10 vjeçar, për njohjen e Librezës së Verbërisë dhe të udhëtimit falas në transportin qytetas, për kategorinë e personave të verëbër.

Duke mbajtur në konsideratë gjithë sa më sipër, Komisioneri konstaton se, Bashkia Kamëz, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për këtë kategori të personave me aftësi të kufizuar, në zbatim të detyrimeve ligjore që asaj i burojnë drejtpërdrejtë nga ligji por edhe nga detyrimet kontraktuale, sipas Kontratës nr. 674, datë 15.02.2017, “Për transportin e udhëtarëve në linjën rrethqytetëse “Kamëz -Tiranë- Kamëz 2”³⁸” të Bashkisë Kamëz.

³⁷ Miratuar me VKM nr. 276, datë 12.05.2021

³⁸ Si dhe Aneks Kontratës me nr. 2023 prot., datë 06.03.2020, bashkëlidhur kësaj Kontrate.

GJEDNJ në jurisprudencën e saj, lidhur me diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara, ka mbajtur qëndrimin se:

“...duke pasur parasysh nevojën për të parandaluar diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe për të nxitur pjesëmarrjen dhe integrimin e tyre të plotë në shoqëri, marzhi i vlerësimit që gëzojnë shtetet në vendosjen e trajtimit të ndryshëm ligjor për personat me aftësi të kufizuara është ndjeshëm i reduktuar³⁹ dhe se për shkak të cenueshmërisë së veçantë të personave me aftësi të kufizuara, një trajtim i tillë do të kërkonte arsye shumë të rëndësishme për t'u justifikuar⁴⁰.”

Bazuar në nenin 33, pika 10 të LMD, përcaktohet se: *“Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”*, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të LMD, përcaktohet:

“Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.

Ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit. Ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuese ndaj subjektit ankues, S. H. dhe të kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, pasi rezultoi se Bashkia Kamëz nuk ka marrë masa për të siguruar të drejtat ligjore të tyre lidhur me udhëtimin falas në transportin qytetas.

Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit dhe garantimin e udhëtimit falas në transportin qytetas, për personat me aftësi të kufizuara, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Komisioneri, gjithashtu nëpërmjet vendimeve të mëparshme të tij: Vendimit nr. 67, datë 10.06.2019, Vendimit nr. 146, datë 06.08.2021⁴¹, Vendimit nr. 174, datë 20.09.2021 dhe Vendimit nr. 66, datë 27.04.2023, ka rekomanduar në vijimësi që, Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të:

- nenit 85, të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore”*, të ndryshuar.
- nenit 11, të Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 *“Për statusin e të verbërit”* (i ndryshuar).

³⁹ Shih: *Glor kundër Zvicrës*, nr.13444/04, prg. 84, GJEDNJ 2009.

⁴⁰ Shih: *Guberina kundër Kroacisë*, nr. 23682/13, 73, GJEDNJ 2016.

⁴¹

- nenit 20, të Ligjit nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”*.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të shtetases S. H. dhe të gjithë kategorisë së personave të verbër, nga ana e Bashkisë Kamëz.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të shtetases S. H. nga ana e Kompanisë *“Shpresa-Al-Transport”* sh.p.k.
3. Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Bashkisë Kamëz, për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie.
4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë Vendim, Bashkia Kamëz të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa për ndryshimet në legjislacion dhe në aktet nënligjore, sipas nenit 20, të Ligjit nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”*.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësi e kufizuar)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)